

RAPORTI I AUDITIMIT PËR FINANCIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE PER PARTINE “ALEANCA ARBNORE KOMBETARE”

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri ligjor

Bazuar ne Ligjin 10019 date 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise” i ndryshuar Ligji Per Partite Politike Nr.8580 date 17/02/2000 i ndryshuar me ligjin nr. 10374 date 10/02/2011, ligjin nr. 17/2014 date 20/02/2014 ligjin nr. 25/2014, date 25/09/2014, ligjin nr. 90/2017 Ligji Nr.10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor Organizimin e profesionit te Audituesit Ligjor dhe Kontablit te te Miratuar, i ndryshuar me Ligjin 10297 date 08/07/2010.
Ligji Nr.9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”
Gjithe dokumentacioni ligjor i marre prane Partise Aleanca Arbnore Kombetare

ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme

Standartet Kombetare te Kontabilitetit qe perdoren ne Shqiperi
Standardi Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimpruresse(SKK për OJF-të)

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

i. Kontrata e shërbimit

Kontrata e shërbimit Nr.5077.Prot date 01/06/2019,lidhur me KQZ-ne.

ii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi Nr. 740 date 31.05.2019.



iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor:

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të dokumentacionit të financimit të fushatës zgjedhore në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

Përgjegjësitë e audituesit ligjor:

Përgjegjësia jone është të shprehim një opinion mbi financimin gjatë fushatës bazuar në auditimin tone, në përputhje me Standartet ndërkombëtare të Auditimit. Keto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse fondet e fushatës zgjedhore nuk kanë anomali materiale. Proçedurat e zgjedhura varen prej gjyqimit të audituesit duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali në fondet e fushatës, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

c. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia "Aleanca Arbnore Kombëtare" AAK, është regjistruar pranë Gjykatës me Vendimin Nr.9760, datë 17.12.2010. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit nr.8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike"

Qëllimi dhe objektivat e partisë pasqyrohen qartë në programin e Statutit të saj.

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)



Partia Aleanca Arbnore Kombetare ka seline qendrore ne Tirane me adrese Rr."Besa" nr.55 dhe nuk ka dege rajonale.

D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

- i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet
- ii. Përmenden takimet dhe komunikimet e mundshme midis audituesit ligjor dhe subjektit zgjedhor dhe çdo person tjetër të tretë

Me lidhjen e kontrates se sherbimit me KQZ-ne ,u paraqitem prane selise se Partise Aleanca Arbnore Kombetare me dt 06/06/2019 dhe kontaktuam me financierin e partise Z.Ferdinand Tarazhi dhe kryetarin Z.Gjet Ndoj.

Auditimi eshte kryer pasi Z. Ferdinand Tarazhi na siguroi dokumentacionin e financimit te fushates zgjedhore dhe nuk pati mangesi ne marrjen e saj.

Z. Ferdinand Tarazhi eshte personi pergjegjes per kontabilitetin dhe nuk pati mangesi ne dhenien e dokumentacionit.

Ne baze te ligjit shqiptar,ka rregulla qe drejtojne financimin e vazhdueshem te veprimtarise se partise politike dhe rregulla te posacme qe zbatohen per financimin e zgjedhjeve. Keto rregulla zbatohen gjate periudhes se fushates zgjedhore. Periudhe e fushates zgjedhore eshte periudha kohore qe fillon 30 dite para dates se zgjedhjeve dhe perfundon 24 ore para fillimit te votimit.

Sipas legjistacionit shqiptar, financimi i fushates i referohet fondeve qe mblidhen dhe perdoren per aktivitetet e fushates zgjedhore. Ketu perfshihen dhurimet monetare, por edhe mallrat ose sherbimet qe ofrohen pa pagese ose me nje cmim te ulur per nje subjekt zgjedhor.

Burimet qe lejohen ne financimin e fushates zgjedhore jane:



- Fondet shteterore
- Te ardhurat e realizuara nga subjekti zgjedhor
- Dhurimet nga burimet private

Kodi zgjedhor rregullon financimin e fushatave zgjedhore te kandidatëve per kryetar bashkie. ligji vendos nje tavan shpenzimi persa i perket qe nje parti politike mund te shpenzoje per qellime te fushates zgjedhore, shume kjo e cila perfshin ne menyre eksplicite edhe shpenzimet e kandidatëve.

Kodi zgjedhor parashikon qe shpenzimet e pergjithshme te bera nga nje parti politike, duke perfshire kandidatet e saj, per nje fushate zgjedhore nuk duhet te kaloje 10 here shumen me te larte qe nje subjekt zgjedhor ka marre nga fondet publike. Kandidatet e pavarur, ose kandidatet e propozuar nga zgjedhesit , i nenshtrohen te njejtave regulla si partite politike/ subjektet zgjedhore, me perjashtim te asaj qe kufiri i shpenzimeve te tyre llogaritet ndryshe. (Neni 90,paragrafi 4 i KZ percakton se shpenzimi total qe mund te kryej kandidati i propozuar nga zgjedhesit nuk duhet te kaloje 50 per qind te shumes me te madhe qe nje subjekt zgjedhor ka marre nga fondet publike)

Subjektit zgjedhor ju kerkua i gjithe informacioni , dokumentet qe kane te bejne me financimin dhe shpenzimet e fushates zgjedhore sipas nenit 91, paragrafi 2 i Kodit Zgjedhor. Keto do te perfshijne:

- Deklaratat e donatoreve
- Dokumentie qe percaktojne identitetin e donatorit
- Kopje te ceqeve te pranuar nga donatoret
- Deklarat bankare nga llogaria e posacme e subjektit zgjedhor
- faturat per te gjitha shpenzimet
- pasqyra permbledhese financiare e llogarise bankare te perdorur per fushate
- Dokumentet qe tregojne vleren e konvertimit te monedhes per donacoinet, pranimet dhe pagesat e bere ne valute te huaj. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë



iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kontrolluar: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit

Raportimi i financimit të fushatës është në përputhje me kërkesat e raportimit dhe është firmosur nga Z.Ferdinand Tarazhi.

II. KËRKESAT FORMALE

A. PËRMBLEDHJE

| 1/ Data e dorëzimit | | | |
|--|---|----|-----------------------------------|
| | a) dorëzim në formë elektronike | Po | Datë 22/08/2019 |
| | b) dorëzim fizik | Po | Datë 22/08/2019 |
| 2/ Nënshkrimi | | | |
| | Nënshkrimi | Po | Datë 22/08/2019 |
| 3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës i financës | | | |
| | a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare | Po | Datë 23/04/2019 |
| | b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës | Po | Nga dt 23/04/2019 deri 30/06/2019 |
| | c) identiteti i personit përgjegjës të financës | Po | Ferdinand Tarazhi |



B. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e veçantë

- A është unike llogaria bankare (vetëm për qëllimin e fushatës zgjedhore) ?

- A është hapur llogaria vetëm për fushatën zgjedhore dhe për të marrë donacionet që kalojnë shumën 100,000 Lekë?

Jo, sepse nuk ka donacione që kalojnë shumën 100,000 lek

- A ka ndonjë llogari bankare tjetër, që është përdorur për të marrë financime publike dhe për të paguar shpenzimet?

Po, është përdorur një llogari bankare për të marrë financimin publik.

- *Raste të llogarive bankare "të fjetura" që janë përdorur për zgjedhjet e mëparshme*

Jo nuk ka raste të llogarive bankare "të fjetura" që janë përdorur për zgjedhjet e mëparshme

- A është i balancuar raporti i financimit të fushatës zgjedhore? A ka deficit?

Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është i balancuar dhe nuk ka deficit

Nga financimet e fushatës zgjedhore 325,275 leke janë përdorur për të mbuluar një deficit të zgjedhjeve të kaluara

- A është siguruar i gjithë informacioni?

- Evidenca e çeljes së llogarisë bankare (data, dokumenti nga banka).



Llogaria bankare eshte çelur ne Raiffeisen Bank me date 23/04/2019,me nr llogarie 0104030780.

- o Dokumenti i lëvizjeve bankare (bank statement) që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.

Po ka dokument te levizjes bankare

b/ Personi përgjegjës për Financën

- Identiteti i personit përgjegjës për financën:

- o Kush? Personi përgjegjës për thesarin (financat) e partisë, kontabilist i licencuar, vullnetar, etj.

Personi pergjegjes per financat e partise eshte Z. Ferdinand Tarazhi, vullnetar.

- o Çështje të mospërputhjeve të mundëshme.

Nuk ka mosperputhje.

- Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:

- o Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore.

Nënshkrimi i raportit të financimit të fushatës zgjedhore eshte bere nga z. Ferdinand Tarazhi

- o Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse: zbulimi i problemeve të paraqitjes (shiko më poshtë)



| | a) bosh/mungon informacioni | Jo | Çfarë? |
|--|--|--------------------|--|
| | b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë) | | |
| | | Të Ardhurat | |
| | | | Financime publike |
| | | | 1,275,000 |
| | | | Donacione private |
| | | | 31,145 |
| | | | Financim nga burimet e veta të partisë |
| | | | S'ka |
| | | | Huatë/Kreditë |
| | | | S'ka |
| | | Shpenzimet | |
| | | | Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës |
| | | | S'ka |
| | | | Materialet promovuese |
| | | | S'ka |
| | | | Media |
| | | | S'ka |
| | | | Sondazhe të Opinionit Publik |
| | | | S'ka |
| | | | Botime |
| | | | S'ka |
| | | | Transporti |
| | | | 210,320 |
| | | | Konsulenca |
| | | | S'ka |
| | | | Reklamime në ambiente të hapura |
| | | | S'ka |
| | | | Administrative dhe të përgjithshme |
| | | | 770,550 |



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

III. TË ARDHURAT

A. PËRMBLEDHJE

| | | Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore | Sipas auditimit të kryer |
|------------------------------|--|--|--------------------------|
| 1/ Financimi publik | | | |
| | Shuma e pagesës paradhënie | 1,275,000 | 1,275,000 |
| | Data e tranfertës | 28/06/2019 | 28/06/2019 |
| | Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve | S'ka | S'ka |
| | Data e transfertës | S'ka | S'ka |
| | Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka(nga zgjedhjet e kaluara) | 325,275 | 325,275 |
| | Data e transfertës | 23/04/2019 | 23/04/2019 |
| 2/ Donacionet private | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | | |
| | Shuma e donacioneve në para | 31,145 | 31,145 |
| | Shuma e donacioneve në natyrë | | |
| | Përgatitet një listë e donatorëve | Donacioni ne para eshte kryer cash nga Z.Gjet Ndoj,ne shumen 31,145 Lek. | Po |
| | Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) | | |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (shuma) | | |



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

| | | | |
|--|--|------|------|
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bakare (bank statement) (data) | | |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori) | | |
| | Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data) | | |
| | A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)? | | |
| | Respektimi i kufirit të donacionit | | |
| 3/ Financimi nga burimet e vetë partisë | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | S'ka | S'ka |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore) | S'ka | S'ka |
| | <i>Kuotat e anëtarësisë</i> | S'ka | S'ka |
| | <i>Botimet</i> | S'ka | S'ka |
| | <i>Shtypshkronja</i> | S'ka | S'ka |
| | <i>Marrje me qera</i> | S'ka | S'ka |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale) | S'ka | S'ka |
| | <i>Kuotat e anëtarësisë</i> | S'ka | S'ka |
| | <i>Botimet</i> | S'ka | S'ka |
| | <i>Shtypshkronja</i> | S'ka | S'ka |
| | <i>Marrje me qera</i> | S'ka | S'ka |
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma) | S'ka | S'ka |
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data) | | S'ka |
| 4/ Huatë/Kreditë | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | S'ka | S'ka |
| | Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua) | S'ka | S'ka |



| | | | |
|--|---|------|------|
| | Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua) | S'ka | S'ka |
| | Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua) | | S'ka |
| 5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave | | | |
| | Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike. | S'ka | S'ka |

B. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave para zgjedhore dhe pas zgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa e caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në deficit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?)

Shuma e mare nga buxheti i shtetit është 1,275,000 leke me dt 28/06/2019 ka qene e mjaftueshme per te mbuluar shpenzimet zgjedhore . Nuk ka deficit.

- Kontrolli i minutazhit që subjekti zgjedhor ka marrë nga çdo sektor i medias që siguron kohë të lirë transmetimi.
- Rasti/et e abuzimit/keqpërdorimit të burimeve publike, që janë burimet e siguruara nga shteti, përveç hapësirës së lirë të reklamave dhe kohës së lirë të transmetimit (*do të trajtohen më me hollësi në pjesën e shpenzimeve*).

Nuk ka patur reklame dhe kohe televizive trasmetimi.

b/ Financimi nga burimet jo publike

Financimet nga burime jo publike jane te kryera nga kryetari i partise z. Gjet Ndoi ne masen 31,145 leke.

- **Donatorët e lejuar:**



- Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar;

Donatori i vetem eshte z. Gjet Ndoji me shumen 31,145 leke dhe jane plotesuar te dhenat e identitetit .

- Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë;

Eshte bere kontrolli i shumes se pergjithshme nga i njejt donator. Shuma e pergjithshme e donacioneve nga i njejt donator eshte 31,145 leke.

- **Burimet e palejuara**

- **Kontributet në natyrë**

Nuk ka kontribut ne natyre.

- **Vlerësimi:**

- Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;
- Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).

- **Kufizimet**

- Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e partisë;



- Kufizimet (pragu i raportimit dhe deklarimit zbatohet si për kontributet në para ashtu edhe për ato në natyrë – *si të garantojmë respektimin e kësaj dispozite kur raportet e financimit të fushatës zgjedhore konsolidojnë llogaritë e selisë së partisë me ato të degëve?*)

c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike

Nuk ka patur financime nga burimet e vete partise politke

- Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë

- Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra
- Botimet
- Shtypshkronjat
- Marrja me qera.....

- Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës

- Zyrat Qendrore
- Degët lokale

- Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruar dhe deklarimit bankar (bank statement) (mund të përdoret edhe termi "nxjerrje e llogarisë")

Ka përputhshmeri midis shumës së të ardhurave të deklaruar dhe bank statment. Shuma e financimit nga buxheti i shtetit e deklaruar në masën 1,275,000 leke përputhet me bank statment.



d/ Huatë/Kreditë

Nuk ka te ardhura nga huatë dhe kredite

- Identiteti i huadhënësit/ve
- Shuma dhe data e huasë/ve (paraqitja e kontratës së kredisë / huasë).
- Data e shlyerjes e përcaktuar në kontratën e kredisë / huasë/ve (*problemi i huave të fshira- në rast dyshimi, e rëndësishme që të theksohet*)
- Normat e interesit (*llogaritet tek shpenzimet si një shpenzim zgjedhor?*)

IV. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

| | | | | | | | |
|--|---|----------------------|------------------------|-----------------------------------|------------------------|--|---|
| Shuma e përgjithshme e raportuar | | 980,370 | | | | | |
| Respektimi i kufirit të shpenzimit | | Po | | | | | |
| Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë | | | | | | | |
| | Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumente mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit |



| | | | | | | | |
|--|---|----------------------|------------------------|-----------------------------------|------------------------|--|---|
| | fushatës zgjedhore | | | | | | |
| Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës | | | | | | | |
| Materialet promovuese | | | | | | | |
| Media | | | | | | | |
| Sondazhet e opinionit publik | | | | | | | |
| Botimet | | | | | | | |
| Transporti | | 210,320 | 210,320 | S'ka | S'ka | S'ka | 210,320 |
| Konsulenca | | | | | | | |
| Reklamat në ambientet e jashtme | | | | | | | |
| Administrative dhe të përgjithshme | | 770,550 | 770,550 | S'ka | S'ka | S'ka | 770,550 |
| Shpenzimet e bëra nga degët e partisë | | | | | | | |
| | Shpenzimet zgjedhore të deklaruar në raportin e financimit të fushatës zgjedhore | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumente mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit |
| Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës | | | | | | | |



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019

| | | | | | | | |
|---|--|--|--|--|--|--|----|
| Materialet promovuese | | | | | | | |
| Media | | | | | | | |
| Sondazhet e opinionit publik | | | | | | | |
| Botimet | | | | | | | |
| Transporti | | | | | | | |
| Konsulenca | | | | | | | |
| Reklamat në ambientet e jashtme | | | | | | | |
| Administrative dhe të përgjithshme | | | | | | | |
| Shpenzimet zgjedhore | | | | | | | |
| Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë | | | | | | | jo |

B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve: 280 milion Lekë → fokusohuni tek “fushatat e shumëfishta” të bëra në nivel qendror dhe degët e partisë në të gjithë vendin;

Partia AAK nuk ka tejkalim të kufirit të shpenzimeve . Totali i shpenzimeve të kryera është në masën 980,870 leke ,përfshirë dhe shpenzimet administrative të kryera në rrethe. Shpenzimet administrative në rrethe janë kryer nga fondi i dhënë nga buxheti i shtetit.

Shuma e financimit publik e kthyer nga zgjedhjet e kaluara është 325,275 leke.

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruar dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.



Nuk ka shpenzime per mitingje dhe aktivitete te fushates.

- **Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës (fokusohuni tek këto);**

- o Pagesa për vendin;
- o Shpenzimet e zbavitjes;
- o Shpenzimet e pajisjeve;
- o Shpenzimet për pijet;
- o Shpenzimet e dekorit/vizuales;
- o Shpenzimet e Transportit;
- o Shpenzimet e Administratës;

- **Materialet promovuese**

- **Media**

- **Sondazhet e opinionit publik**

- **Botimet**

- **Transporti**

- **Konsulenca**

- **Reklamat në ambientet e jashtme**

- **Administrative dhe të përgjithshme**

KUJDES: Për secilën kategori të shpenzimeve, analizoni:

- Natyrën zgjedhore të shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore;

Shpenzimet e kryear gjate fushates jane shpenzime transporti dhe administrative.

- Ekzistencës dhe/ose zbulimit të shpenzimeve të paligjshme (keqpërdorimi i burimeve publike / blerja e votës). Sidoqoftë, këto shpenzime, të paligjshme nga natyra, duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogaritet si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.



Nuk ka shpenzime te paligjshme (keqperdorim te burimeve publike/ blerje e votes

- Shpenzimeve që janë bërë para fillimit të fushatës zgjedhore (që nga 5 Dhjetori e më pas) duhen llogaritur dhe këto shpenzime të llogariten si tejkalim i kufirit të shpenzimeve.

Nuk ka shpenzimepara fillimit te fushates.

- *Raportimi i shpenzimeve në natyrë. Duhet të ekzistojë një përputhshmëri me donacionet në natyrë.*

Nuk ka shpenzime ne natyre.

V. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

1-Partia Aleanca Arbnore Kombetare ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me Ligjin Per Partite Politike Nr.8580 date 17/02/2000 i ndryshuar, si dhe me statutin e saj.

2- Partia Aleanca Arbnore Kombetare ka mare financim publik nga buxheti i shtetit 1,275,000 leke me dt 28/06/2019.

3- Nuk ka hapur nje llogari te posacme per fushaten se nuk ka donatore me shumen mbi 100,000 leke.

4- Donatori i vetem eshte z. Gjet Ndoj me shumen 31,145 leke. Z. Gjet Ndoj ka plotesuar deklaraten mbi konfliktin e interesit per financimin e subjekteve zgjedhore



5- Totali i shpenzimeve eshte 980,870 leke dhe perbehet nga shpenzime transporti dhe adinistrative.

Raporti i financimit te fushates zgjedhore eshte i balancuar dhe nuk ka defiçit.

6- Shuma e financimit publik e kthyer nga zgjedhjet e kaluara eshte 325,275 leke.

- o Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit

- 1- Nga fiancimi publik jane kryer shpenzime administartive nga deget ne masen 690,000 leke. Keto shpenzime jane kryer pa dokumenta fiskal.

- o Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiarë?

-Nga krahasimi me raportin e monitorimit te ekspertit fiskal u konstatua:

- 1- Nga raporti i monitorimit u vu re se Partia Aleanca Arbnore nuk kishte zyra elektorale dhe ne raportin e saj financiar nuk kishte shpenzime qeraje per zyra.

- 2 -Gjate monitorimit u vu re se nuk kishte aktivitete dhe mitingje elektorale dhe ne raportin e saj financiar nuk kishte shpenzime :

- Pagesa për vendin;

- Shpenzimet e zbavitjes;

- Shpenzimet e pajisjeve;

- Shpenzimet për pijet;



-Shpenzimet e dekorit/vizuales;

3- Gjate monitorimit u vu re se nuk kishte materiale propagantistike më shumë se 5 metra nga zyra zgjedhore dhe ne raportin financiar nuk kishte shpenzime per materiale propagantistike (Flamuj, banderola etj)

B. PËRFUNDIMI

a. Çertifikimi me përmirësime

Ne kemi audituar financimin e shpenzimeve te fushates zgjedhore per zgjedhjet lokale te Partise Aleanca Arbnore Kombetare, permbledhjen financiare dhe deklaratat ne perputhje me kerkesat e raportimit te miratuara nga KQZ-ja.

Sipas opinionit tonë, me perjashtim te pa rregullsive te gjetura me siper pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, *(ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për)*, financimin e shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet lokale nga Partia Aleanca Arbnore Kombetare, në përputhje me modelin tip te raportimit te miratura nga KQZ-ja.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, *(ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për)*, financimin e shpenzimeve te kryera gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet lokale nga Partia Aleanca Arbnore Kombetare, në përputhje me modelin tip te raportimit te miratura nga KQZ-ja.



Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.



Miratuar me Vendimin nr. 152 datë 11.04.2019